



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TËLO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.782/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, Z. Blerim Dina - Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T. “Biti-Com” - Podujevë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, NTSH “Lulishtja Buçaj” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lule dhe drunjë dekorativ”, me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Prishtinë, më datën: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.T. “Biti-Com” - Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me lule dhe drunjë dekorativ”, me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me lule dhe drunjë dekorativ”, me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T. “Biti-Com” - Podujevë, aprovet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

AR SYETIM

Operatori ekonomik ankues N.T. "Biti-Com" - Podujevë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 08.10.2020 me nr. 782/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me lule dhe drunjë dekorativ", me numër të prokurimit: 616-20-1766-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 27, 52, 59, 69 dhe nenin 70 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe neni 39 tek Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 14.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e datës 26.10.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit është:

	13.2	Shuma e Sigurimit të Tenderit është 4000 për periudhë valide prej <i>shëno kohëzgjatjen në ditë</i>
--	------	--

Ndërsa në dosjen e tenderit validiteti i ofertave është kërkuar 90 ditë, shih më poshtë:

Periudha vlefshmërisë së tenderit	22.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 90 ditë
-----------------------------------	------	---

Ndërsa në njoftimin për kontratë është kërkuar:

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit 4000

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët 90 apo muajt

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit, si dhe të njoftimit për kontratë, siç shihet edhe më lartë, po ashtu duke pasur parasysh se para ofertimit ka mundur të sqarohet kjo çështje, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues N.T. “Biti-Com”, nuk e ka ofruar sigurimin prej 120 ditësh, por sigurimin e tenderit e ka ofruar nga Kompania e sigurimeve (SIGURI), për periudhë 90 ditë dhe në vlerë 4,000.00€. Pra, sigurimi i tenderit nuk është konform kërkesës, për më tepër mund t’i referoni pjesës tabelore të nenit 39 të RRUOPP-së.

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
---	---	----

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. “Lulishtja Buçaj”, menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi, i cili është Bachelor i Agro Ekonomisë, nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar Agronom i Diplomuar.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë është: “OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit.” Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim ne projektin përkatëse, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE”.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. “Lulishtja Buçaj”, në dosjen e tenderit e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull “Bachelor i Agro Ekonomisë”, shih më poshtë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I BUIQESISË DHE VETERINARISË NE PRISHTINE

REPUBLIC OF KOSOVO
UNIVERSITY OF PRISHTINA
"HASAN PRISHTINA"



FACULTY OF AGRICULTURE AND VETERINARY IN PRISHTINA

LEOTRIM NASER KRASNIQI

U lind me 04.06.1991 në Lipjan.
U regjistrua në vitin akademik 2010/2011.
Studimet i mbaroi me 23 korrik 2015 në:
DREJTIMI AGRO EKONOMI

Born on 04.06.1991 in Lipjan.
Was enrolled in the academic year 2010/2011.
Completed his/her studies on 23 July 2015 in:
AGRO - ECONOMY

dhe mori titullin:
BACHELOR I AGRO EKONOMISË

and was awarded the title:
BACHELOR OF AGRO - ECONOMY

Niveli i kualifikimit sipas **Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6**
Gjendje: 180 pike - ECTS
Nota mesatare gjate studimeve 6.53
Prishtine, 1 shtator 2015

Level of qualification according to the **National Qualifications Framework: 6**
Total ECTS 180
Average grade of studies 6.53
Prishtina, 1 September 2015

Nr. 447

Dekani / Dean
Prof. Asoc. Dr. Bedri Dragusha



Rrektori / Rector
Prof. Dr. Ramadan Zejnullahu

Në raportin e ekspertizës me nr.517/20, kam sqaruar se kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është "Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi)", ndërsa në diplomë shënon "Bachelor i Agro Ekonomi", si dhe duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe dëshminë e ofruar, kam sqaron se konform nenit 59.2 të LPP-së, AK-së është dashur të kërkoj sqarime shitesë nga organi kompetent që e ka leshur diplomën, për gradën "Bachelor i Agro Ekonomi".

Në vendimin PSH. Nr.517/20, të dt:17.09.2020, Paneli ka konstatuar, shih më poshtë:

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues NT "BITI-COM", se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NTP "LULISHTJA BUÇAJ", menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi, i cili është Bachelor i Agro Ekonomisë, nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar AGRONOM I DIPLOMUAR. Paneli shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të

njoftimit për kontratë është: "OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit Menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit". Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatës, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE".

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar për këtë pikë nga OE i rekomanduar sqaron se i njëjti në dosjen e tenderit për kërkesën e cekur si më lartë, e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull "BACHELLOR I AGROEKONOMISË".

Kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është "Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi)", ndërsa në Diplomë shënon "BACHELOR I AGRO EKONOMI".

Paneli shqyrtues duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe dokumentacionin e ofruar nga AK sqaron se AK gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59. 2 dhe 72 të LPP-së në mënyrë që të vërtetoj nga organi kompetent që ka lëshuar diplomën dhe të vërtetoj se a janë të barabarta gradat me sistemin e ri të studimeve, më saktësisht a janë të barazvlefshme grada "bachelor i Agroekonomisë" me "Agronom i diplomuar" dhe që AK të specifikoj çartë se a përputhet diploma e oruar nga OE i rekomanduar me kërkesën e bërë nga ata.

Autoriteti Kontraktues, sa i përket menaxherit të projektit z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull "BACHELOR I AGROEKONOMISË", e arsyeton në këtë mënyrë, shih dëshmitë:

Sipas vendimit të OSHP-së nr.517/20 të datës: 17.09.2020 është kërkuar që dëshmohet menaxheri i projektit Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Sipas RREGULLORES PER STUDIME THEMELORE – BACHELOR për Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të datës: 17.10.2008 – thekson si në vijim:

Në bazë të nenit 100 pika 2 e 3 e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Këshilli i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në mbledhjen e mbajtur më 17.10.2008 nxori këtë

RREGULLORE PER STUDIME THEMELORE – BACHELOR

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohen këto çështje:

- Llojet e studimeve;
- Kushtet e regjistrimit në studime;
- Kohëzgjatja e studimeve;
- Statusi i studentit;
- Të drejtat dhe detyrimet e studentëve;
- Kushti i regjistrimit të vitit;
- Afatet, paraqitja dhe mënyrat e dhënies së provimeve;
- Përfundimi i studimeve dhe punimi i diplomës;
- Përgjegjësia disiplinore;
- Dispozitat kalimtare.

I

Llojet e studimeve

Neni 2

Me qëllim të përgatitjes së kuadrit për veprimtari profesionale dhe kërkimore-shkencore Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, organizon studime të rregullta, me vetfinancim (që nuk financohen nga fondet publike), dhe studime me korrespondencë.

Neni 3

Studimet në Departamentin e Veterinarisë, organizohen vetëm të rregullta dhe kohëzgjatja e tyre është pesë vite.

Neni 4

Studimet themelore-Bachelor organizohen në këto Departamente:

1. Agroekonomi
2. Blegtori
3. Lavërtari-Perimtari
4. Mbrojtje të bimëve,
5. Pemëtari-Vreshtari

Neni 5

Mësimi realizohet në formë të: ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teknike, ushtrimeve në laborator, punës praktike në terren, ekskursioneve shkencore-mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmjet punimeve të pavarura të studentëve.

Neni 6

Studimet me korrespondencë mund të vijohën, pa shpëputje dhe me shpëputje nga puna, kombinimi i këtyre mënyrave të studimit, ashtu siç parashihet me Ligjin e Arsimit të Lartë të Kosovës dhe me Statut të Universitetit të Prishtinës.

II

Neni 41

Për hartimin e punimit të diplomës është paraparë afati prej së paku 3 e më së shumti 12 muaj nga dita e zyrtarizimit. Në raste të arsyeshme ky afat mund të zgjatet edhe për dy muaj. Kërkesën për zgjatjen e afatit të përfundimit të temës së diplomës me arsyetim përkatës e bën studenti, ndërsa vendimin për aprovim e merr Dekani i Fakultetit.

Neni 42

Në fillim të çdo viti të ri akademik Departamentet e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë i paraqesin, propozimet e temave të punimit të diplomave.

Propozimi i temave të punimit të diplomave bëhet nga secili mësimdhënës në departamentin e caktuar. Mësimdhënësi që ka propozuar temën e punimit të diplomës e udhëheq studentin në rolin e mentorit deri në përfundim të punimit të diplomës.

Brenda një viti akademik, mësimdhënësi nuk mund të ngarkohet me më shumë se 5 punime të diplomës, për raste të jashtëzakonshme (në mungesë të mësimdhënësve në Departament) ky numër mund të shtohet me Vendim të Dekanit.

Neni 43

Punimin e diplomës studenti e dorëzon në pesë ekzemplare së paku 7 ditë para mbrojtjes, në shërbimin të studentëve. Dekani e lejon mbrojtjen, cakton komisionin dhe datën e mbrojtjes. Nëse punimi vlerësohet pozitivisht, shkruhet raport në procesverbal të mbrojtjes nga anëtarët e komisionit.

Neni 44

Mbrojtja e punimit të diplomës është publike dhe zhvillohet para Komisionit të përbërë nga tre anëtarë (mentorit dhe dy anëtarëve të lëmit të ngushtë me temën) të propozuar nga mentori i punimit të temës, që miratohet nga Dekani i Fakultetit.

Gjatë mbrojtjes me gojë të punimit të diplomës nga ana e kandidatit, komisioni mbanë procesverbalin.

Komisioni e vlerëson punimin e diplomës në pajtim me kriteret e përcaktuara dhe vlerësimin me note e shënon në Procesverbal dhe Indeks.

Neni 45

Kandidati i cili punimin e diplomës nuk e ka dorëzuar në afatit e zgjatur, punimi i diplomës me shkrim dhe gojë nuk ka qenë e suksesshme i caktohet punimi i ri i diplomës.

Neni 46

Studenti i cili përfundon me sukses studimet Bachelor fiton thirrjen akademike Bachelor i Shkencave Bujqësore për Drejtimin përkatës.

Diplomën për kryerjen e studimeve Bachelor e nënshkruan Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit. Përmbyllet dhe formën e diplomës e përcakton MASHT-i.

IX

Përgjegjësi disiplinore

Neni 47

Studentet që i shkelin rëndë rregullat, mund të përjashtohen përgjithmonë ose përkohësisht nga Universiteti-Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Studentët e dënuar për shkelje kanë të drejtë të ankohen Këshillit të Fakultetit.

Studentët e përjashtuar kanë të drejtë t'i ankohen Senatit të Universitetit, i cili mund të konfirmoj ose të zhvlerësoj vendimin e Këshillit të Fakultetit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit. *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Me respekt,

Departamenti i Prokurimit

Andaj, duke pasur parasysh vendimin PSH.Nr.517/20, të dt:17.09.2020 dhe arsyetimin AK-së në Vendimin mbi njoftimin, eksperti shqyrtues sqaron se AK-së nuk ka vepruar konform vendimit PSH.Nr.517/20, të dt:17.09.2020, por është thirrur në Rregulloren për Studime Themelore – Bachelor.

Eksperti shqyrtues konstaton se OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se Certifikatat e origjinës së mallit Itali, ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. “LULISHTJA BUÇAJ”, janë të dyshimta (të falsifikuara).

Sa i përket pretendimeve në lidhje me Certifikatat dhe Licencat e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës, ku OE ankues NT “BITI-COM”, pretendon se janë të falsifikuara, eksperti shqyrtues sqaron se kjo çështje është përgjegjësi i organeve përgjegjëse që merren me këto punë, nuk është përgjegjësia jonë kjo si dhe nuk kemi mekanizmat e nevojshme për tu marrë me vërtetësinë e këtyre dokumenteve.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të anulohet, lënda të kthehet në rivlerësim.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 26.10.2020 i ka njoftuar palët me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues me date 04.11.2020 përmes parashtresës me shkrim ka njoftuar OSHP-ne si me poshtë: Përhëndetje të nderuar panelistë dhe zyrtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)!

Së pari ju kërkojmë ndjesë për vonesën lidhur me përgjigjet në ekspertizën me nr.782/20 që ka të bëjë me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me lule dhe drunjë dekorativ”, me nr. të prok: 616-20-1766-1-1-1.

Eksperti i çështjes z. Hysni Muhadri në ekspertizën e tij ka theksuar që lënda duhet të rikthehet në rivlerësim.

Të nderuar panelistë të OSHP-së ne nuk pajtohemi fare me ekspertizën e z. Muhadri e aq më tepër kjo ekspertizë paraqet kundërligjshmëri sepse z. Muhadri ka kontestuar në tërësi Rregulloren e Brendshme për Studime në nivel Bachelor dhe nivel Master të Fakultetit të Veterinarisë dhe Bujqësisë.

Duhet theksuar që Rregullorja e Brendshme për Studime në nivel Bachelor dhe nivel Master të Fakultetit të Veterinarisë dhe Bujqësisë derivon nga aktet ndërkombëtare që përkrahin sistemin e Bolonjës për studime dhe me të cilat diploma e fituar vërtetohet me nivel të studimeve Bachelor dhe Master.

Nga kjo rrjedh edhe provat e bashkëngjitura në këtë email ku keni dy rregulloret për nivelin e studimeve në Fakultetin e Veterinarisë dhe Bujqësisë. Ju lutem shih nenin 4 dhe nenin 46 të

Rregullores mbi studimet e nivelit Bachelor të Fakultetit të Veterinarisë dhe Bujqësisë. Poashtu shihnenin 11 të Rregullores për studime të nivelit Master.

Duke ju prezantuar provat që dëshmojnë që të mos aprovohet ekspertiza me elemente të kundërligjshme mbesim në pritje të vendimit meritore në bazë të vendimit që ka nxjerrur Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës.

Ju faleminderit për mirëkuptim.

Me respekt,
Departamenti i Prokurimit.

Operatori Ekonomik nuk është deklaruar se a pajtohen apo nuk pajtohen me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T. “Biti-Com” – Podujevë që ka të bëjë me vlefshmërinë e sigurisë së tenderit, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit është që shuma e sigurimit të tenderit të jetë 4,000.00 euro, validiteti i ofertave 90 ditë, kurse në njoftimin për kontratë është kërkuar që periudha e vlefshmërisë së tenderit të jetë 90 ditë, vlera e sigurisë së tenderit 4,000.00 euro, si dhe vlefshmëria e sigurisë së tenderit të jetë 120 ditë. Lidhur me këtë kërkesë OE ankues N.T. “Biti-Com”, nuk e ka ofruar sigurimin prej 120 ditësh, por sigurimin e tenderit e ka ofruar nga Kompania e sigurimeve (SIGURI) për periudhë 90 ditë dhe në vlerë 4,000.00€. Pra, sigurimi i tenderit nuk është konform kërkesës. Për më tepër, në pjesën tabelore të nenit 39 të RRUOPP-së është përcaktuar që tenderi do të refuzohet kur sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjesë e dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues NT “BITI-COM”, se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. “Lulishtja Buçaj”, menaxherin Leotrim (Naser) Krasniqi, i cili është Bachelor i Agro Ekonomisë, nuk e ka ofruar konform kërkesës së dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku është kërkuar Agronom i Diplomuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë është: “OE duhet të emëroj menaxherin e projektit, i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi). Në rast të grupit menaxheri duhet të jetë pjesë e stafit të Liderit.” Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: “OE në kuadër të stafit duhet të ketë një deklaratë origjinale ku emërton menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Agronom i diplomuar (Drejtimi Agroekonomi) ose marrëveshje paraprake për angazhim në projektin përkatës, me së paku 3 vite përvojë pune në OE e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin (e noterizuar), kontratën e punës, dëshmi mbi përvojën e punës nga ATK-ja, të jetë në listën e të punësuarve në OE dhe të ofroj së paku 3 referenca për menaxhim të suksesshëm të projekteve të ngjashme në OE”.

Kurse OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. “Lulishtja Buçaj”, në dosjen e tenderit e ka ofruar z. Leotrim (NASER) Krasniqi, me titull ““Bachelor i Agro Ekonomisë”, ku eksperti e ka bashkangjitur në raport kopjen e diplomës së personit në fjalë.

Për këtë kërkesë të AK-së, në vendimin PSH.Nr.517/20 të dt:17.09.2020, Paneli ka konstatuar dhe i ka dhënë udhëzime AK-së që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga organi kompetent që e ka lëshuar diplomën, duke kërkuar sqarime nëse përputhet diploma e ofruar me kërkesën e AK-së. Përkundrazi, AK nuk ka kërkuar sqarime sikurse është udhëzuar por e ka arsyetuar duke u bazuar në Rregullore për Studime Themelore – Bachelor të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Në këtë rregullore përcaktohen departamentet e studimeve dhe çështje tjera, e të cilat nuk japin sqarime nëse diploma bachelor është ekuivalente me kërkesën e AK-së. Andaj, duke pasur parasysh vendimin PSH.Nr.517/20, të dt:17.09.2020 dhe arsyetimin AK-së në Vendimin mbi njoftimin, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk ka vepruar konform vendimit PSH.Nr.517/20, të dt:17.09.2020, por është thirrur në Rregulloren për Studime Themelore – Bachelor. Pra, obligohet AK që të zbatoj vendimin paraprak dhe të kërkoj sqarime shtesë konform udhëzimeve të cilat janë dhënë nga Paneli Shqyrtues.

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankues NT “BITI-COM”, se certifikatat e origjinës së mallit Itali të ofruara nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T.P. “LULISHTJA BUÇAJ”, janë të dyshimta (të falsifikuara).

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kjo çështje është përgjegjësi e organeve përgjegjëse që merren me këto punë, nuk është përgjegjësi dhe kompetencë e OSHP-së që të vërtetoj nëse janë të falsifikuara sepse nuk kemi mekanizmat e nevojshme për tu marrë me vërtetësinë e këtyre dokumenteve mirëpo këto pretendime duhet ti vërtetoj AK gjatë rivlerësimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim

se AK nuk ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, duke kërkuar nga organi kompetent nëse diploma në fjalë është në harmoni me kërkesën e AK-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se **nëse** të dy Operatoret Ekonomik si ankuesi po ashtu edhe OE i rekomanduar për kontratë janë të pa përgjegjshëm por pasi që për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar edhe operator tjerë gjatë rivlerësimit Autoriteti duhet të shpall fitues Operatorin që i plotëson të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues të vendosura në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe vlerësimi të bëhet konform nenit 59 të LPP-se, duke e respektuar njëkohësisht edhe nenin 60.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nubi PAÇARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna Prishtinë;
- 1x1 OE N.T. "Biti-Com" – Podujevë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.